

# NUTRIKA

Botimet OSHTIMA

Tiranë, nr. 2 shkurt 2017

Bëhu Fresh!

Nëse do të duhej të të jepja këshilla, si më i vogël që je, do të të jepja vetëm një: anëtarësohu në FRESSH!

Anëtarësimi është gjëja më e lehtë, të mjafton të mendosh ndryshe, si gjithë të tjerët, të duhen dhe ca këmisha e buzëqeshje të duhura, sidomos këto të fundit; si çdo aspirant kandidat duhet të dish, dhe sigurisht që di, se buzët e varura nuk dalin mirë në televizor, madje më keq, japin përshtypjen që po mendon se gjërat nuk shkojnë mirë. Nëse do të shfaqesh se mendon, por gjëra të thella e jo shqetësuese, atëherë thjesht të duhen një palë syze, nga ato të mëdhatë, janë në modë tani, kuptohet pa numër, qetësuese i quajnë, dhe menjëherë të gjithë kuptojnë që ti kalon orë e orë të tëra përpara kompjuterit duke studiuar.

Dhe karriera nuk është e vështirë, mund të arrish të bëhesh kryetar. Për këtë të duhet pak impenjim, të kuptohemi, për hir të zotit asgjë e vështirë – me që ra fjala, tani të kuqtë i kanë mirë punët me zotin, pagëzohen, pagëzojnë, martohen në kishë, bëjnë syneti; është mirë, kupton, mbaje mend. Duhet të mësosh vetëm pak folklor komunist; gjëra interneti, nja dy këngë të De Gregorit apo Manu Çaos (thjesht titujt, ë!, se asnjë s'ka pse ngarkohet shumë), të duhen dhe nja dy citime të Çe Gevarës ose të Gramshit; edhe këtu nuk ka nevojë të ngarkohesh, ca meme fejsbuku dhe je në rregull. Kuptohet, duhet të dish ndarjen e së mirës nga e keqja; këtu të ndihmoj unë: "Çe Gevara ishte një i ri idealist, i pëlqente motori, udhëtimet dhe liria", kaq mo!

vijon në faqen 2

Lirija

Pres SS-Kolonelit A. Schmidhuber  
Komanant i Divizionit Malsuer SS  
"Skanderbeg"

Ç'është lirija?

Me fjalën liri englezët kuptojnë mënyrën se si me shtrydhë ekonomikisht popujt e tjerë, deri sa këta të vorfënohen dhe ata vetë të pasunohen.

Sunduesit jahudi-kapitalist t'Amerikës kuptojnë nën fjalën liri të drejtën me shtie në dorë tanë Botën, për me fitue ata vetë sa mâ tepër pare. Bolshevikët e Ruis me fjalën liri kuptojnë të drejtën me shfarue ç'do jetë kombtare të vetën, të popujve të ndryshëm dhe me e ndryshue Botën mbarë me anë të systemit të komisarve në një shoqni të madhe tregtare jahudish.

vijon në faqen 8

Në brendi

Djalëri e pruar, Djalëri e hallevë -  
Koha e re, poezi nga Asdreni - Fjalimi i  
Thereza May, kryeministre e BM -  
Diktatura Europiane - Divizioni 21  
malor i SS të armatosura  
"Skanderbeg" - Roli i të majtës në  
fenomenet emigruese - Teatri partizan  
eksperimental - Popullariteti si problem  
- Valuta, puna dhe dekadencat

Se për pak harrova, që të bëhesh udhëheqës, duhet të dalësh përpara një jurie. Skemën e ke të qartë: katër veta, një skenë, një mikrofon, një pulsant... dhe ti vlen. Është e qartë, përpara jurisë duhet të flasësh, mos u shqetëso, sa më shumë skema boshe të ngresh dhe fjalë të huaja të përdorësh aq më mirë është, shiko po ngece mos e vra mendjen, fol sa shtypëse, e prapambetur dhe patriakale është shoqëria shqiptare dhe je në rregull. Ki parasysh që nuk kanë rëndësi realiteti apo realizueshmëria e gjërave që thua – po ti! – etërit themelues morën në qafë gjysmën e botës me kopaçet që këpusnin; ti në një konkurs bukuri je. E di, do më thuash që je i turpshëm; edhe!, jetojmë në kohë relative, jetojmë në kohë ku defekti dhe padija janë virtyt. Kije parasysh, kjo është pika jote e fortë, pasi ti ke mendimin tënd.

Nëse kjo skemë të duket e vështirë, mendo për kohët e vjetra, kur duhet të takohesh dhe bindje qindra njerëz, të flisje përpara njëmijë të tjerëve që të kundërshtonin, kur ndonjëherë ngrihej, si i thonë sot, edhe zëri, kur duhet të shkruaje në gazetë, kur duhet të organizoje, ngrije struktura... jo or bos jo, je me fat, shoqëria e sotme nuk ju ngarkon.

Do më thuash: gjithë kjo puna sikur bie pak erë?! Edhe! Boll tani me teori konspirative. Pastaj, dëgjo, anëtarësinë nuk ta heq njeri, e aq më pak ekskursionet, edhe jashtë shtetit ë! E di ti, me autobus e gjëra. Pastaj ke kampet verore, e ke vetë parasysh, i ke sheshit: bar, gjoks e bythë; tani kjo e fundit sikur është më në modë, por ta thash jetojmë në kohëra relative e ti ke lirinë tënde.

Edhe në shkollë, mësuesit e pedagogët do të shohin me sy tjetër. Je rinia aktive, je i impenjuar, je shpresa, ke kuptuar botën dhe në fund të fundit je i yni, e për këtë nuk ka nevojë të të ngarkojnë shumë. Nuk duhet të harrosh, madje duhet ta kujtosh çdo ditë,

që më të mirat vinë me kohën. Anëtarin njëh, njihet, takon, mëson dhe kështu përgatitet për vendin e punës. Nuk do rritani të të shpjegoj si futesh në punë, e ke vetë të qartë, ndonjëherë qëllon që të shkosh në shkollë për letërsi e përfundon ekonomist, por mos harro që nuk duhet të rrimë skillever të skemave të vjetërsuara.

Tani, për të thënë të vërtetën, këto gjëra nuk janë falas, nuk janë pa kosto. Duhet të shkosh në takime, të duartrokasësh (kemi breza të tërë duartrokitësish e ç'i ka gjetur?! Asgjë, shëndosh janë), të bësh fotografi fesjbuku, të mësosh artin e bindjes, të lajkut, shërit, rituitit, të mbysësh kritikën dhe të buzëqeshësh, të buzëqeshësh shumë pasi ti mundesh. Si e sheh, pa u ngarkuar, asgjë pa të cilën nuk ecet përpara.

E di, je i ri e mund të të vijë ndonjë gjë e çuditshme ndër mend, diçka e tipit, një ditë do të dorëzosh fëmijën tënd në të njëjtën gjendje, në të njëjtin ambient, në të njëjtën arrati nga përgjegjësitë; broçkulla idealiste!. Në fund të fundit, kur të të vijë vakti kjo puna e fëmijëve do ketë dalë fare nga moda – shokët kanë kohë që përpiqen – ose të paktën do jetë një lëmsh i atillë që as do e dish i kujt është fëmija yt e as e kujt do jetë gruaja jote – por ama një grua që kursen një milionë dollarë – shef ti ça bëhet, prandaj mos e vra mendjen për këto gjëra.

Të them dhe të fundit fare: nuk do fresh, bëhu lëre, ose libra – e, me këta bëhesh kryetar partie po deshe; ose ose, mund të luash dhe lojëra revolucionarësh, për pak kohë, kuptohet, por po më dëgjove bëhu fresh, buzëqesh dhe e ardhmja do të jetë e ndritur.

Herri

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## I. Djalëria e "preruar"

Rroba shik... Këmishë të mëndafshta... Parfume... Ballo... Në plazhe... Bridge... në Klub... Bisedime rreth politikës ndërkombëtare... Thashetheme të etikës dhe të konvencionalizmit! Këto janë preokupacionet e djalërisë sonë të preruar de la notre jeunesse dorée! Se kemi dhe ne, dalngadalë, një djalëri naziqe, që me duar të holla, e të bardha, e të manukyruara, e me mjaft koketeri, e me fare pakë tru në kokë, përpiqet të bëhet elita e këtij vëndi dhe të zërë dalngadalë vendet e komandës, duke mos pasur ndër mënd veçse të mirat që rrjedhin nga këto vende. Dhe kjo djalëria e preruar që ka shumë elasticitet dhe që di të ngjitet pa bërë as zhurmë, as punë, ka ecur mjaft. Kështu kemi sot, sidomos në Tiranë dhe ca më pak në qendrat e tjera të mëdha, një klasë të rijsh, që të veshur e të ngjeshur dhe të armatosur dhe shkathtësinë banale të njerëzve pa personalitet, kanë edhe pozita, edhe pretendime, dhe mbanë tjetër si justifikim për këto pozita e pretendime kanë mosinteresimin e plotë për problemet dhe hallet e vëndit; përmbushjen e detyrave të tyre krejt burokratike, por si një angari e mërzitshme; përmbuzjen e çdo gjëje dhe të çdo zakoni, që është tipikërisht shqiptar, bile duke mos fole as shqip sa doherë që munden e duke u kujdesur vetëm për qejfet dhe mirëqenien e tyre, sikur të ishin një bote krejt më vete e jo pjellë e këtij vëndi, që rron në sajë dhe në kurriz të këtij vëndi. Mjerisht kemi disa tipa të tillë, të cilët dita-ditës fusin në rrethin e tyre edhe ndonjë të ri naiv e të papjekur në jetë. Dhe këtë e pohojmë me ballë të hapët dhe pa frikë të një përgënjeshtimi të sigurtë nga këndonjësit e sigurtë dhe të mençur. Sepse ky, fatkeqësisht, është realitet. Na, që kemi luftuar të vjetërit ashpërisht dikur, edhe i kemi justifikuar për gabimet dhe fajet e tyre. Sepse të rritur në klima dhe kondita të ndryshme, nuk mund të

ishin veçse ashtu siç janë. Po nuk do të mundemi të justifikojmë rritjen e këtyre tipave të rij të preruar, që dashas e pa dashas po zënë vëndin e të vjetërve si klasë, duke krijuar kështu një konfuzion të madh në jetën shqiptare, sepse kështu fillon të duket sikur edhe djalëria nuk mund të prodhojë veçse të këtilla tipa, të cilët nga shumë pikëpamje nuk janë më pak të dëmshëm nga të vjetërit.

Ka nga këta tipa të preruar, të cilëve po t'u flasish për filmat më të bukur, për soiretë luksoze, për plazhet, për bridge e ku ta di unë, janë në gjendje të të japin një tok ndriçime dhe drejtime. Por po t'u flasish për ndonjë problem të Dukagjinit, Kosovës, Dibrës, Mallakastrës apo Himarës, dinë të të thonë aq pak, sa ç'mund të dijë të të thotë një dansuer frëng apo vienes. Dhe ky lloj tipi, i rritur në luks e me përkëdhelje, ka pretendime për pozita dhe pozita për pretendime.

Ndofta dikujt do t'i vijë keq për këtë qëndrim të ashpër. Edhe ne na vjen keq, por s'mund të heshtim. Një gazetë si kjo jona, që merret me problemet jetike të vëndit, do të qëllojë. Dhe sot po qëllojmë pikërisht një nga pikat më të dobëta dhe më të rrezikshmet të jetës shqiptare. Na do të ishim të parët që do të gëzoheshim, po të na provohej se jemi të gabuar. Po sot jemi shumë afër të vërtetës, mjerisht. Dhe të vërtetat duhen thënë haptazi, sa do tronditëse dhe armiqësore që të duken. Sepse kur nuk thuhet haptazi, bëhen kangrenë e pashërueshme. Dhe ne s'kemi aspak kohë për kangrenë të re. Me përpjekje dhe dhembje mundohemi të shërojmë ato, që trashëguam nga e shkuara jonë e palumtur. Nuk është nevoja të lejojmë që të zënë bukë, siç thotë fjala e popullit, edhe kangrenë të reja.

Djalëria jonë e preruar, djalëria jonë e shikllëkut, e aristokracisë, e ballove dhe e qejfeve, kjo djalëri, që nuk mendon se ku është dhe pse është ç'i përket të bëjë, por që të gjitha fuqitë i saj i harxhon për të

siguruar ç'duhet për të jetuar sa më ëmbël dhe sa më dëfryeshëm, ajo djalëri aristokratike, që përbuz çdo gjë shqiptare dhe që s'ka hapur kurrë as një libër gramatike të shqipes e që prandaj çdo dhjetë fjalë që rreshton, bën pesë gabime, kjo nuk është djalëria që i duhet dhe që i hyn në punë këtij vëndi. Përkundrazi. Këtij vëndi i duhet një djalëri që të quhet djalëria e halleve dhe sakrificave.

Ismet Toto, «Arbënia», 1936

## II. Djalëria e "Halleve"

Përkundrajt togut të vogël të djalërisë së "përaruar", mbi të cilën folmë dje, qëndron e shëndoshë dhe e pastër turma e madhe e djalërisë shqiptare, e rritur me bukë misri, me përkëdheljet dhe rreptësinë e gjuhës së ëmbël të nënës e të babës, në anë të vatrave tona plot bekim dhe me frymën dhe tingullin e sigurtë dhe të prerë, që ka çdo njeri që lindi dhe u rrit në këtë Atdhe. Dhe nga mesi i kësaj djalërie, nga mesi i djemve të vëndit, kanë dalë mjaft tipa të shëndoshë, që kanë provuar se kanë një vullnet të ngulur, një dashuri të pakufishme për këtë Atdhe, dhe një ndjenjë të lartë durimi e sakrifice për qëllime të larta shoqërore e kombëtare. Brënda nga gjiri i kësaj djalërie kanë dalë shumica e djemve me tru, me zëmër dhe me zë të qeruar, të cilët kanë bërë vepra e kanë thënë fjalë, që janë dëgjuar me dashuri nga ky popull. Dhe mjerisht, këta djem të sigurtë e të shëndoshë të vëndit, që nuk kanë shkathësinë e duhur për të ecur shpejt përpara, për shkak të kryelartësisë së tyre dhe karakterit të drejtë, kanë mbetur qosheve, të panjohur, të paçmuar e pak si të përbuzur. Është një realitet i hidhur ky. Na e themi, sepse e ndjejmë thellë dhe, sepse kemi besuar dhe besojmë fanatikisht, se vlera më e madhe e popullit shqiptar përmbledhet pikërisht tek ajo djalëri që na e quajmë: djalëria e halleve dhe e sakrificave.

Djalëria e halleve, sepse ka idera të larta në kokë. Mendon shqiptarisht dhe kombëtarisht. I shkruan energjitë e saj vetëm e vetëm për t'i vlyer vëndit. E ndien misionin e saj, i ndien thellë theoritë e atyre që ranë në fushat e lavdisë dhe të nderit, duke pasur në gojë vetëm një emër: Shqipërinë! E dashuron Atdhenë dhe është kryelart që është shqiptare.

Djalëria e sakrificave, sepse kjo është zonja të derdhë mund e djerës, e gjak në shërbim të Atdheut e Mbretit. Kjo djalëri, pra, djalëria e halleve dhe e sakrificave, është shpresa dhe vlera e këtij vëndi. Djalëria naziqe e manikyrëve dhe e ballove, dhe e brixhit, është një prodhim anormal i disa rrethanave të ndryshme të jetës sonë shoqërore. Ajo djalëro duhet të ndërrojë udhë ose të zhduket. Shqipëria është një Atdhe, që kërkon mundim dhe sakrificë të çuditshme. Nuk është vendi ku duhet të shkohet koha me ballo e muhabete të ëmbëla. Këtu është vendi i punës dhe i mendimit. Është vendi ku njerëzit, nga pikëpamja e vullnetit, e guximit dhe frymës së sakrificës, duhet të jenë si japonezët. Si ata japonezë, që brënda gjysmë shekulli ngritën një perandori dhe një qytetërim.

Kjo lloj djalërie, e punës dhe e mendimit, dhe e sakrificave të mëdha, i bën kombet të lavdishëm, të lumtur dhe ngadhnjyes. Ato vende, në të cilat djalëria është e dhënë pas qejfeve, pas luksit dhe pas koketerisë, ato vende janë të destinuara të vdesin.

Fatbardhësisht turmat e djalërisë shqiptare janë të pastëra si bora në mal.

Ismet Toto, «Arbënia», 1936

Vargjet më poshtë, janë një poezi e panjohur e Asdrenit. E mohuar dhe e braktisur prej shumë vitesh, sepse armiqtë i trembeshin, miqtë nuk ishin miq dhe bashkëpunëtorët u varrosën, rikthehet sot për shkelmin armiqve, dorën vëllezërve dhe krahët djemve.

Koha e Re

Besim, Bindje, Luftim  
Mussolini

I  
Besim!  
Athdhë i shtrenjtë Shqipëri  
Pas aqë shekujsh skllavëri,  
Të ré durove robëri  
Gjersa t'-u shojt edhe pak liri  
Për 'të që derdhe trimëri  
Me djersa, gjak dhe flori,  
Me 'tó dhe lulen Djalëri!  
Gadi njëzet e pesë vjet  
Një fat i keq seç' të pat gjet;  
Në vojte trupi i-yt u-tret  
Si një dëshmor me të vërtët  
Me një Malok pa ménd  
Q'ish vetë Ligj e vetë Shtet!  
Ay për ty që veç një zot  
Tiran me fjalë kuptimplot,  
T'a shtrydhi trupin mot për mot  
Gjithmonë t'i mbushte arkat plot  
Me shokë që të vinte ndot!  
Ti po rënkoje kot-e-kot  
Me sytë mbushur gjith me lot!

II  
Bindje!  
Fatlum o Shqipëri për nderin e math që pate  
Një trup të bëhesh sot me Vëndin miqësor.  
Ndër shekuj që shkelqen me më të mbarat fate  
T'i-arrijë gjer në kulm Pushtetit shekullor!  
Sot ke një Mbret të Math si s'ka gjekund tjetër  
I drejtë Sundimtar me shpirt plot dhempshuri,  
Prej Kombit më bujar, prej fisit më të vjetër,  
I denjë fort Ushtar plot lavd e trimëri!  
Sot Roma flet kudo me zërin e saj kumbonjës  
Me Burrin-zot q'e prin i Shtetit Kryetar,

Me krahn' e fort të tij, me syn'e tij veshgonjës  
Vargonjsh që të çliroj me hovin shpëtimtar.  
Një frymë-e ré fillon nén shejat e Liktorit  
Që ngjall e që flakron dhe forcë q'ep të ré,  
Mbi trup më mos durosh kallvarin e dëshmorit  
As lodër më mos jesh kujdo nga fqinjët pré!  
Për Mbret e Duçe pra të bindesh me nderime  
Dy burra që për ty s'kursejnë dashuri,  
Me 'ta lavdi fitofsh dhe famë nër veprime  
Më lart e lart t'arrijsh në dije-e mjeshtëri!  
Gjithmonë mbroth të vetsh si hyll që të  
shkëlqesh  
Prej Territ të pa fund të dalësh në Rilindje,  
Me Kombin sot vëlla me 'të ndaj ballit t'jesh:  
Me Nder dhe Krenari, Ndërgjegje plot dhe  
«Bindje»!

III  
Luftim!  
Çdo Komb lëfton për një qëllim  
Qëllim të shenjtë për liri,  
Liri që s'ka në botë çmim  
Kur e fiton me trimëri!  
Dhe Shqipëria pati fat  
Me mund t'i dalë vehtes zot  
T'i mbledhë bijt' e saj q'i pat;  
Por mund-i saj seç vajti kot!  
Se mise trupi pa i-u dasht  
Me mish prej mishit krejt të vet  
I-u prenë keq dhe-i mbetnë jasht;  
Me gjak të saj q'u-skuq një det!  
Bërtiste se çdo mis e dhëmb:  
Por bota nuk i vinte vesh,  
Se më s'i mbetej gjak në rrëmb:  
Stolis'së trupit seç' u-çvesh!  
Si gjah për fqinjët kishte mbet  
Më-i forti nj'aq sa desh rrëmbëu  
Kur s'ke fuqi, di seç të pret,  
S'të ndih as Qjelli që të kreu!  
Por çdo padrejtës s'duron  
Sa kohë ndodhet lart një Gjyq,  
Lart qjelli me të zeza ré  
Kot prisnje frymë krejt të ré  
Çdo shpresë jete ty t'u pré  
Kurrkush as më s'të vinte ré:  
Veç për kusartë ishe pré!



Sot mbaj-u mos u-dëshpro  
 Si trimëreshë prap qëndro  
 Si burrë frikës mos i-u-dro,  
 Se ka një Syq ë të vështron  
 Prej çdo së keqe ty të mpron,  
 Çdo plagë trupi t'a shëron:  
 Shëndetin t'ê po t'a kërkon!  
 Një fat i ri ty sot t'u-hap  
 Që vjen me n'jaq të shpejttë çap  
 Të bardha ditë sjell me vrap:  
 Tekdo një dritë që përhap!

Që tash mos jij në shqetësim  
 Përmbli th fuqit' e jep-u vlerësim;  
 Atdhé! lart çoji kryet me kuxim:  
 Një Burr'i Math të thotë, kij «Besim»!  
 Me sy të mprehtë që vështron  
 Si të mbërthejnë ty mbi Kryq!  
 Për 'tâ q'u-bëre shpesh thërror  
 Sa mbete fare lakuriq.  
 Pa zê në trollin t'ënd lindor,  
 Nga miq q'i ke gjithmonë armiq.  
 Të lindur vetëm për lakmi;  
 Një rrip na lanë me diçka,  
 Né mbetëm pak, në vetëmi:  
 Atà u-mfrynë sa një kâ!

Por... Shqipëria ka një Hyj  
 Q'e shtrihu dorën për mbi 'tê  
 Kurorë rreth me Djell e hyj  
 Q'e ndrit me rrezet edh'atê!  
 Me mbret të ndritshëm që s'ka shok  
 Ka nder të rrij në kuvënd;  
 Me Kombin-mik q'u-bë një tok  
 T'i-a sjellë trupin prap mbë vënd!  
 Me Prijës-Shteti kuximtar  
 Që s'njuh kurrkund asnjë ndalim,  
 Çdo ças, kur ke një kundërshtar:  
 Gatit-u, thotë, për «Luftim»!

Prill 1940

ASDREN

«Shkëndija», nr. 2, gusht 1940, f. 19-21

Në këto kohë kur në anët tona është rishfaqur Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, për të çmontuar dhe atë pak sovranitet të mbetur, vendosim të botojmë një pjesë nga fjalimi mbajtur nga kryeministrja britanike Theresa May më 17 janar 2017 me rastin e shkëputjes së vendit të saj nga Bashkimi Evropian.

Fjalimi i Theresa May ndjek dy linja kryesore: atë të politikës së jashtme, pra të nevojës për marrëdhënie ekonomike dhe politike të lira për Britaninë e Madhe, pa diktatin mbishtetëror dhe bazuar në historinë dhe interesin shtetëror britanik dhe, sidomos, të politikës së brendshme, pra të nevojës për rivendosjen e sovranitetit shtetëror, vetëvendosjes së popullit, demokracisë, miratimit të ligjeve në Uestminster, Edimburg, Kardif e Belfast dhe interpretimin e tyre jo nga gjykatësit e Luksemburgut por nga ata britanikë.

Një mesazh nga Britania e Madhe për pjesën tjetër të Evropës

Është e rëndësishme të pranojmë këtë fakt. 23 qershori nuk është dita në të cilën Britania e Madhe vendosi të veçohet nga bota. Është dita në të cilën vendosëm të ndërtojmë në Britani të Madhe me të vërtetë globale.

E di që ky fakt – dhe arsyet e tjera që shtyn Britaninë e Madhe të merrte këtë vendim – shpeshherë nuk kuptohet nga miqtë dhe aleatët tanë evropianë. E di që shumë druhen se kjo mund të shënojë nisjen e shpërbërjes së Bashkimit Evropian.

Dua të jem e qartë në këtë pikë: nuk dëshiroj që kjo të ndodhë. Nuk do të ishte në interesin e Britanisë së Madhe. Është fakt i qartë dhe shumë i rëndësishëm se interesi britanik është që BE-ja të mund të jetë e suksesshme. Ja përse shpresoj që në muaj dhe vitet në vijim të nxjerrim mësim nga vendimi i Britanisë së Madhe për të dalë.

Gjej rastin këtu për të parashtruar arsyet e vendimit tonë dhe t'ju përgjigjem drejtpërsëdrejti shtetasve evropianë.

Nuk bëhet fjalë vetëm për faktin që historia dhe kultura jonë janë thellësisht ndërshtetërore, edhe pse ky fakt është shumë i rëndësishëm. Shumë njerëz në Britaninë e Madhe gjithmonë kanë menduar se roli ynë në BE ishte në kurriz të lidhjeve tona globale dhe të një përqafimi më të plotë të tregtisë së lirë me pjesën tjetër të botës.

Ka dhe arsye të tjera shumë të rëndësishme.

Traditat tona politike janë të ndryshme. Në dallim nga shumë vende evropiane, nuk kemi një Kushtetutë të shkruar, por parimi i sovranitetit parlamentar qëndron në themel të Kushtetutës tonë të pashkruar. Vetëm së fundi kemi një histori qeverie të decentralizuar – edhe pse zuri vend shpejt – dhe nuk kemi përvojë me qeveri koalicioni. Njerëzit duan që të munden t'i kërkojnë llogari qeverisë së tyre në mënyrë shumë më të drejtpërdrejtë, dhe institucione mbishtetërore të forta, si ato të krijuara nga Bashkimi Evropian bien ndesh me historinë tonë politike dhe me stilin tonë të jetesës.

E di që shpeshherë Britania e Madhe është parë si një Shtet anëtar problematik, Bashkimi Evropian has vështirësi në ballafaqimin me dallimet ndërmjet anëtarëve dhe interesave të tyre. Synon drejt uniformizimit, jo fleksibilitetit. Bisedimet e David Cameron-it përfaqësuan një përpjekje guximtare dhe përfundimtare për të bërë që BE-ja të ishte funksionuese për Britaninë – dhe dua të falënderojë të gjithë ata që në Evropë u përpoqën për arritjen e një marrëveshjeje – por siç e dimë e vërteta është se për shumë çështje të rëndësishme, për votuesit britanikë nuk kishte fleksibilitet të mjaftueshëm.

Tani, unë nuk besoj se këto çështje i përkasin vetëm Britanisë së Madhe. Britania e Madhe nuk është i vetmi Shtet anëtar me një lidhje të fortë me qeverisjen

e përgjegjshme dhe demokratike, me një mentalitet të fortë internacionalist apo me bindjen që dallimet në gjirin e Evropës duhen vlerësuar.

Pra, jam e bindur se Brexit-i vlen si mësim, jo vetëm për Britaninë, por, nëse dëshiron të ketë sukses, edhe për vetë Bashkimin Evropian.

Forca e madhe e kontinentit tonë ka qëndruar gjithmonë te dallimet. Ka dy mënyra për t'u marrë me interesat e ndryshme. Mund të përgjigjesh duke u përpjekur me forcë, duke i shtrënguar në një darë e cila në fund do të shkërmoqi pikërisht gjërat që dëshiron të mbrojë, ose mund të respektohen dallimet, madje dhe të vlerësohen, dhe të reformohet Bashkimi Evropian në mënyrë që të përshtatet më mirë me dallimet e mrekullueshme mes Shteteve anëtare.

Prandaj më lejoni t'u them diçka miqve tanë në të gjithë Evropën:

Vota jonë për të lënë Bashkimin Evropian nuk do të thotë mohim i vlerave që kemi të përbashkëta. Nuk paraqet dëshirën për t'u larguar nga ju, miq e fqinjë. Nuk është një përpjekje për të dëmtuar BE-në apo ndonjë nga vendet anëtare. Nuk duam të kthejmë mbrapa orën, kur Evropa ishte më pak paqësore, më pak e sigurt dhe më pak e aftë për të bërë tregti lirisht. Për ne ishte një votë për rivendosjen e demokracisë tonë parlamentare, vetëvendosjen tonë kombëtare, për t'u bërë edhe më globalist e ndërshtetërore në shpirt dhe veprime.

Do të vazhdojmë të jemi partnerë të besueshëm, aleatë vullnetmirë dhe miq të mirë. Duam të blejmë mallrat dhe shërbimet tuaja, t'ju shesim tonat, të bëjmë tregti bashkë sa më lirshëm të jetë e mundur, të punojmë së bashku për të bërë të mundur, që nëpërmjet një miqësie afatgjatë, të gjithë të jemi më të sigurt, më të mbrojtur e më të begatë.

Do të jeni përsëri të mirëseardhur në vendin tonë, ashtu si shpresojmë që dhe shtetasit tanë të jenë te ju.

Në një moment ku duhet të përballlemi me kërcënimet e rënda të armiqve tanë, shërbimet e afta britanike do të vazhdojnë të bashkëpunojnë për të mbrojtur shtetasit e Evropës nga terrorizmi. Në këto kohë kur rriten shqetësimet lidhur me sigurinë evropiane, burrat dhe gratë e Britanisë me shërbim në vende si Estonia, Polonia dhe Rumania, do të vazhdojnë të kryejnë detyrën e tyre.

Ne po largohemi nga Bashkimi Evropian, jo nga Evropa.


Për këtë arsye ne kërkojmë të arrijmë një marrëveshje të re dhe të ndershme partneriteti – ndërmjet një Britanie Globale të pavarur, të vetëvendosur dhe miqve dhe aleatëve tanë në BE.

Jo një anëtarësi të pjesshme në Bashkimin Evropian, ndonjë lloj asocimi apo ndonjë qëndrim tjetër të dyzuar. Nuk kërkojmë të vëmë në jetë modele të përdorura nga vende të tjerë. Nuk kërkojmë të ruajmë copëza nga ajo që po braktisim.

Jo, Mbretëria e Bashkuar po lë Bashkimin Evropian dhe është detyra ime të arrij një marrëveshje të drejtë për Britaninë e Madhe.

Theresa May, Lancaster House, 17 janar 2017.

Botuar në The Telegraph  
Përkthimi Red. Nutrika



## Lirija

vijon nga faqja 1

Kurse Gjermanija me fjalën liri kupton të drejtën e sejcilit popull me ba një jetë si mas dokeve e cilsis të veçantë të tij dhe të drejtën e sejcilit popull me korrë e gëzue aj vetë pemët e punës e zellit të vet. Pranaj Gjermanija si pionjer i Evropës kërkon lirin e Evropës nga influencat jashtevropiane, që gjithmonë kanë pasë për qëllim me mbjellë ndër popujt e Evropës disharmoni, për me mujtë kështu me i shtrydhë ekonomikisht ma kollaj. Prandaj Gjermanija mori lirinë me kundërshtue, që mos t'i thithet gjaku ma prej ebraizmit kapitalist dhe mos të shmoralizohet ma prej ebraizmit bolshevik.

Lloj-lloj asht kuptimi i fjalës "Liri". Kuptimi mvaret prej sojit të racës dhe prej karakterit, d.m.th. prisave të seicilit popull. Por jo të gjithë popujt kanë prisë prej race të vet. Shifet çiltazi që Rusia ka prisë jahudij, si Amerika, po ashtu edhe Anglija nën rogozën monarhike. Ndër këto vende populli e kupton fjalën liri n'atë mënyrë si e kanë mësue prisat e huej. Pse lirija ebraike asht qëllimi i sundimit ebraik të Botës.

Asht gabim, kur Shqiptarët besojnë se ata nuk kanë punë me jahudij. Traktatet e paqes mbas luftës botnore së fundit janë kjenë diktate të sunduesve jahudij. Në themel të këtyne diktateve të jahudijve u-coptue Shqipnija, hupi Kosova lirin dhe i a dhenë një populli krejt të huej. Vetëm këtë gja të shkueme mos me e harrue, mjafton që Shqiptari të kuptojë rrezikun e ebraizmit dhe të veprojë përshtatshmënisht.

Ebraizmi botnuer po lufton për me fitue lirin, me shtrydhë ekonomikisht tanë Botën, tue çue në kasaphanën e luftës popujt e Ruisis, Anglis dhe t'Amerikës.

E natyrisht Shqipnin nuk kishte me e përjashtue; Ebraizmi kishte me i



dhanë Kosovën si bakshish po atyne jugosllavëve, që luftuen për atë dhe sunduesit e vjetër të Kosovës kishin me i a hupë Kosovës lirin një herë e për gjithmonë.

Edhe Titoja, agjenti i ebraizmit bolshevik, ashtu tue ba një luftë për "Liri", me anën e "Ushtris Shlirimtare Jugosllave". Kosovarët kanë pasë besue, se këjo Ushtrie, si pansllaviste që asht, nuk kishte me e prekë kufinin shqiptar. Kosovari gaboi. Titoja sulmoi Kosovën edhe Sanxhakun. Tash Kosovari e ndien me veshët e vet, shka ma para nuk e besonte. Kështu asht kjenë qysh prej kohëve të lashta dhe kështu ka me kjenë gjithmon, që liria e vërtetë e një kombi, e drejta me ba një jetë si mbas zakoneve të veta dhe e drejta me gëzue pemët e punës së vet, nuk falet, as nuk duhet të ngeli e falun. Aji, që tash nuk lufton për lirin e vet, nuk ka të drejtë me jetue.

Krah për krah me djemt e SS. të Divizionit "Skanderbeg" dhe me ushtarët shqiptar, luftuen edhe vullnetarë, d.m.th. të tillë burra, që kanë vullnet për liri. Por nuk mjafton vetëm vullneti. Vullneti duhet të jetë i pajisun me disiplinën ma të fortë. Pa disiplinë nuk ka liri. Një disiplinë e lehtë asht hapi i parë për me hupë lirin. Mungesa e disiplinës shkakton robni. Disiplina asht një element i kulturës ma të naltë, kur mbështetet në vullnetin e lirë të një populli të përparuem.

Fuqija dhe forca e qëndresës gjermane, siç po duket edhe një herë nën zjarrin e tmerrshëm të granatave dhe bombave t'ushtris invazionit anglo-amerikan, bazohet pikë së pari mbi disiplinën kombtare vullnetare. Kuptimin e ka në thirrjen: "Pris, urdhno, na të ndjekim!"

Kuptimi i disiplinës asht kuptimi i urdhnimit dhe i bindjes. Luftëtarë pa disiplinë nuk kanë asnjë vleftë në luftën moderne. Forca morale e vullnetit për liri lypset të organizohet taktikisht e teknikisht për me mujtë me durue me ngadhnim luftën moderne.

Prandaj prisi Adolf Hitlero po i jep Divizionit Shqiptar SS. "Skanderbeg" instruktora gjerman dhe armë gjermane ma moderne, që të mundet me e mprojtë me sukses lirin e Kosovës.

Një këtu asht ndryshimi: Ingelzët pajisin çetat komuniste pansllaviste të Titos me armë e tesha angleze, që të ja rrëmbejnë Kosovës lirin, kurse Gjermanija po i jep Kosovarëve armë dhe tesha gjermane, që të mundet me mprojtë lirin e vet. Prandaj shqiptari mundet me e dallue vetë, se kush prej këtyne dyve asht miku i vërtet: Anglija a po Gjermanija?

Sikuer kësaj here bandat e Titos, të pajisun me material englez, kërkuen me hye në Kosovë, nesër mund të ndodhi, që Englezët të shkarkojnë në Kosovë me aeroplana pansllavista të armatosun e të veshun me material englez me oficera englez. Asht mirë me e parashikue një mundësi të tillë dhe me u-pregatitë.

Këtë përgatitje nuk duhet t'a bajë Komiteti i Lidhjes së Prizrenit ose Komandat ushtarake, por, mbasi asht në rrezik liria e popullit për kohën e ardhëshme, asht detyra e sejcilit katund, e sejcilit burrë, që mundet me luftue. Lufta për liri e lyp, që, kur të zbresin jugosllavët e komanduem prej anglezve, që sejcili burrë t' sulmojë për një herë e mos i lajë kohë atyne me u grumbullue e gatitë për luftë. Ç'do pritje për me marrë urdhna asht krim kundër liris.

Vetëm grushti i forët dhe ndjeshja gjoks me gjoks mundet me shpëtue në të ktilla raste, katundet e popullin e Kosovës në zonën e shkarkimit, nga rrënimi. E kanë gabim ata, që besojnë, se tash në kohën e mashinkave, bombave e granateve, trimnija e burrnija e kanë hupë vleftën. Vendimtar nuk asht materiali, por shpirti, besimi në fuqin e vet dhe vullneti për liri, të gjitha këto të shkrime prej një discipline të fortë e të pathyeshme. Në një katund, ku ka 100 burra t'armatosun, duhet të jetë vetëm një qi urdhnon. Të tjerët duhet të binden pa kushte. Ata marrin urdhën

me sulme, me hye në rreshtet e anmikut, me e shkatërrue ose me e mbajte një posicjon deri në pikën e fundit të gjakut. Aji, që shkon mbrapa pa urdhën, ose arratiset, asht një kriminel i liris. Kur asht pun me ruejtë lirin e popullit, kurrkush nuk asht i liri me ruejtë vehten e vet. Kosovarë, keni pasë besue, se Titoja nuk ka me ju sulmue. Kosovarë, tash i besoni me kohë rrezikut ma t'afërm dhe përgatituni!

«Lidhja e Prizrenit», V. 1, Nr. 15, 25. VI.

1944 f. 1.

Ida Magli (1925 – 2016) antropologe, filozofe dhe akademike italiane dhe një nga zërat më origjinal të mendimit shkencor dhe politik në Evropë. Në vitin 1982 u nderua me çmimin Brancati për letërsinë, një ndër më të rëndësishmit në Itali. Për një kohë të gjatë bashkëpunoi me redaksitë e "La Repubblica", "L'Espresso" dhe "Il Giornale" Magli, që prej fillimit të viteve '90 rreshtohet hapur kundër bashkimit të Evropës, duke e cilësuar si një "projekt dështak". Në rastin e sulmeve masive të refugjatëve në Këln të Gjermanisë, ndaj grave vendase u shpreh se "është vetë Brukseli që kërkon përsheptimin e shkatërrimit përfundimtar të qytetërimit evropian". Gazetari Giordano Bruno Guerri, në vitin 2015, do të shprehej se Magli nuk të mëson ç'të mendosh, të mëson të mendosh.

Ida Magli

Diktatura evropiane

Hyrje

Kur shkrova Kundër Evropës dija vetëm një gjë: që bashkimi i Evropës ishte një ide krejtësisht kundër arsyes dhe historisë. Shoqëritë dhe kulturat nuk mund të ecin mbrapsht, nuk mund të shkojnë në regres, ashtu si dhe speciet: ose shkojnë përpara drejt progresit, drejt formës, ose zhduken. Gjermania, Franca, Italia, Anglia (vetëm për të përmendur disa prej vendeve që u thirrën në themelimin e BE-së) kishin arritur të bëheshin "Kombe", me individualitetin e tyre, në territor, kufij, peizazhe, në atdhe, në gjuhë, letërsi, arte, muzikë, bukuri, qytetërim, përmes një rrugëtimi të gjatë historik, sepse "kjo të qenit Komb", ishte "forma" e qytetërimit që aspironin: e plotë, e fortë, e pjekur, e lumtur. Kishin ndjekur këtë model me sforcim, punë, zgjuarsi, beteja, gjak dhe heroizëm shekullor.

Katastrofa e Luftës së Dytë Botërore (një luftë, ndryshe nga si ndodh shpesh, që është e gabuar ta shikosh si vazhdim i të parës, sepse përmbajtja politike, arsyet dhe qëllimet ishin krejtësisht të ndryshme) nuk bënte pjesë në rrjedhën logjike të historisë së tyre, përkundrazi, mori formë si një thyerje tragjike. Këtë e provon, të paktën për sa i përket Italisë, aleanca e lidhur nga Musolini me Gjermaninë, e para tradhti e tij e vërtetë ndaj italianëve, duke qenë se bëhej fjalë jo vetëm për një aleancë antihistorike, por mbi të gjitha ishte një fyerje për ndjeshmërinë e një populli që sapo kishte dalë me beteja të stërgjata nga mbizotërimi i Perandorisë gjermane. Nuk është provë përkujtimi i Redipuljas me njëqindmijë të vdekurit...

Shpikja e Evropës

Një labirint fals

Kisha ndjekur etapat katastrofike të traktateve, pothuajse të panjohura nga qytetarët, me të cilat ishte vendosur

në tavolinë që Kombet nuk do të kishin më kufij brenda Evropës, për të "favorizuar qarkullimin e njerëzve dhe mallrave"; isha dëshmitare e sjelljes shtypëse me të cilën krerët e shteteve dhe qeverive, duke mohuar edhe atë pak respekt për demokracinë, i kishin nënshkruar pa ua paraqitur përmbajtjen opinionit publik, duke bërë përjashtim vetëm ndonjë dokument sipërfaqësor edhe në atë rast krejtësisht me qëllim për të mos u kuptuar rëndësia. Kisha parë me habi peripecitë e pabesueshme të atyre pak referendumeve mbajtur për ratifikimin e Traktateve, dhe padurimin e shpallur me të cilin u përulën ato qeveri që ishin detyruar nga një diktim kushtetues. Nëse nuk do bëhej fjalë për vendime të rëndësishme për pavarësinë dhe sovranitetin e Kombeve, "koncerti" i referendumeve, paraqitur si kopje, deri sa këta të jepnin rezultatin pozitiv që pritej, mund të prezantohej shumë mirë si një "gjetje" në ndonjë spektakël komik për fëmijë.

Por edhe të flasësh, diskutosh, shkruash, hap pas hapi kur dilnin në dritë pasojat negative të bashkimit, duke filluar nga ajo e efektit shumë të rëndë të shkëmbimit nga lireta në euro, në tregun italian, ishte e kotë. Askush nuk po ndërmerre ndonjë veprim. Ishte atëherë që më në fund u binda: duhej patjetër të ishin në veprim arsye dhe një vullnet që nuk e njihja nëse çdo here që kisha ndjekur një vijë logjike me fakte domethënëse për të kuptuar qëllimet e vërteta të projektit evropian, kisha përfunduar në një rrugicë qorre. Në një moment mu shfaq me qartësi shpjegimi: më kishin "detyruar" të lundroja në një koklavitje kontradiktash dhe përgjigjesh negative. Bëhej fjalë për një koklavitje të përcaktuar posaçërisht; rrugët e ndryshme nuk të çonin në asnjë vend sepse nuk gjendesha në një labirint edhe pse e kishte formën të tillë, por në një labirint "fals"...

Ndërtuesit e Bashkimit kur futën shtetësinë evropiane në Traktatin e

Mastrihtit, me vetëdije të plotë e kanalizuan procesin drejt një pseudointegrimit "kombëtar".

Ishte një vendim jo legjitim sepse BE-ja nuk është një Shtet dhe gjithë shtetasit e Bashkimit ndërkohë e kanë atë të vetë Shtetit të tyre; por bëhej fjalë të vihej në zbatim e njëjta strategji "iluzioni që ndërton realitet". "Shtetësi", ama, nënkupton "Atdhe", nënkupton gjuhë, ndjenja, dhembshuri, emocione, përkatësi, miliona jetë të sakrifikuara për atë dhe mbi të gjitha: kujtesa. Kujtesa që vjen nga ajo botë "e largët", që për njeriun është çdo gjë që e rrethon para se të lindte, me të cilën ai identifikohet edhe pse nuk e njeh; e "largëta" e asaj historie populli të cilit i përket, që i lejon të ndihet i përfshirë në një mënyrë të veçantë në atë që ndryshe do të ishte, si për kafshët, vijimësia pa formë e jetës. Kush ka përcaktuar në tavolinë që Evropa duhet të bëhet "një atdhe", është jo vetëm një shpirt i varfër, por edhe një armik i njerëzimit...

Homoseksualizmi si nxitës i barazisë  
Është për ti shtuar diçka ama, shumë fenomeneve që duhen studiuar për të kuptuar rrugët që "laboratori" ka vendosur ndjek në heshtje në aspektin psikokulturor: homoseksualizmin.

Në rastin e vrasjes së Pim Fortuyn\*, ashtu si dhe në rastin e vdekjes së Haider , doli papritur në skenë tema e homoseksualizmit, edhe pse nuk kishte asnjë arsye. Homoseksualizmi i Fortuyn-it ishte një fakt i njohur për të gjithë pasi ai vetë nuk e kishte fshehur kurrë. Sa i përket Haider-it\*\* përkundrazi ishte një lajm absolutisht i ri, për të cilin nuk ishte folur kurrë, aq sa u mohua menjëherë nga të gjithë, përfshirë edhe familjen e tij. Nuk kishte në fakt asnjë provë, por ishte një sajese me të cilën dëshirohej të arrihej një qëllim: të krijohesh ideja që edhe një njeri aq i sigurt dhe i sigurt në vete dhe në idetë e tij, si Hajderi, i fortë, aq "burrë", t'ju kishte fshehur diçka atyre që besonin te ai. Por meqë hetimi mbi vdekjen e tij,

sipas një procedure të sajuar siç duhet, u mbyll shpejt, u mbyll dhe diskutimi mbi këtë problem dhe nuk u fol më. Për të kuptuar cilat janë qëllimet dhe strategjia që ka vendosur të ndjekë "Laboratori" nuk duhet të anashkalojmë një "detaj" shumë të rëndësishëm. Qëllimi është i qartë: të arrihet në atë strukturë të re sociale për të cilën " modeli botëror " ka nevojë. Strategjia mbështet në përdorimin e homoseksualizmit si faktor aktiv. "Faktor aktiv" do të thotë që mund të funksionojë dhe funksionon, si në kuptimin pozitiv dhe atë negativ, si një shtresë kulturore që normalisht gjendet në dinamikën sociale. Nën vizoj "normalisht gjendet" meqë homoseksualizmi nuk ka qenë kurrë deri dje as në shoqërinë tonë dhe në asnjë tjetër. Nuk bëhet fjalë këtu për të diskutuar një argument kaq të gjerë dhe që është trajtuar shumë herë nga antropologët, sociologët, psikologët, historianët, për të mos folur për seksologët dhe teologët. Për sa mund të zgjatemi pafundësisht tek kjo çështje, një fakt mbetet i pandryshueshëm, homoseksualizmi është steril. Si i tillë nuk mund të konsiderohet normal në asnjë shoqëri, duke qenë se detyra kryesore, si natyrore apo kulturore e një grupi, cilado qofshin idealet, synimet, instrumentet e tij teknologjik dhe shkencor, është të sigurojë mbijetesën në kohë. Është e qartë, përkundrazi që në shoqërinë e sotshme homoseksualizmi është "shtyrë" të shfaqet dhe të kthehet, siç po thosha, në faktor aktiv, normal, i dinamikës sociale, me një shpërndarje të mëdha forcash në të gjitha fushat për të përmbysur gjykimin e përgjithshëm negativ: reklama, moda, mjetet e komunikimit, spektaklet televizive dhe filmat, lidhshipi në politikë, mirëkuptimin moral, martesat. Mënyra se si u vu në zbatim ishte analoge, përveç përmasave, me ato të mirë studiuar të reklamave: e nxori çështjen në sipërfaqe duke lidhur me një personazh të njohur, një "gjigandi" që të kujton heronj të së shkuarës, që në momentin kur vdes, e

kthen vlerën e tij të "fuqishme" në absolute.

Njëkohësisht me tronditjen që shkakton ky emocion, sugjerojnë kuptimet e reja: janë homoseksuale edhe drejtuesit karizmatikë në kuptimin më të fuqishëm, atë të aksionit politik, në organizimin në grup, në atë që ndikon më shumë tek të gjithë aspektet konkrete të shoqërisë, në të tashmen e tij, në ardhmen e tij. Pra, jo më një fenomen që ka të bëjë me sjelljen personale të individit, në çdo rast pakice edhe pse mbi të gjitha kur shfaqet si atribut i njerëzve të jashtëzakonshëm si gjigandët e kinemasë dhe këngëtarët, madje si faktor pozitiv shumice (tashmë pranohet si të ishte fakt i njohur që të gjithë njerëzit janë homoseksuale edhe pse kanë gra dhe fëmijë) dhe plot me energji që seksualizmi vjetër dhe i mërziutshëm burrë – grua nuk ka pasur kurrë. Është e kotë të shtojmë që bëhet fjalë për meshkuj, vetëm dhe vetëm për një raport seksual midis meshkujsh.

---

\*(19.02.1948 – 6.02.2002, politikan hollandez, homoseksual me ide politike që shkonin nga socializmi, komunizmi deri në liberal konservatore, u vra nga një aktivist i mbrojtjes së kafshëve)

\*\* (26.01.1950 – 11.11.2008, politikan dhe qeveritar i suksesshëm austriak i të djathtës ekstreme. Po të mos kishte vdekur papritur, partia e tij do të fitonte zgjedhjet në Austri)



Divizioni 21 malor i SS të armatosura "Skanderbeg" (Shqiptar nr. 1)

### Krijimi

Ideja e krijimit të një Divizioni SS e përbërë vetëm me shqiptarë u diskutua ditët e para të marsit 1944 në Gjermani. Pala shqiptare përfaqësohej nga zëvendësministri i punëve të jashtme Vehbi Frashëri dhe pala gjermane prej sekretarit shtetëror Steengraht.<sup>1</sup> Duke qenë se forcat SS ishin forca të armatosura të shtetit gjerman, ky i fundit ruante të drejtat e komandimit, armatimit, etj. Pjesa që i mbetej palës shqiptare ishte vetëm rekrutimi. Nojbaheri këshillonte që formimi të mos bëhej në Gjermani por të bëhej në Shqipërinë e veriut sepse sipas tij, "kosovarët garantonin një forcë morale vepruese kundër elementëve armiqësorë".<sup>2</sup> Në Divizionin SS Hanxhar ndodhej një regjiment i gjithi me shqiptarë, dhe që ishte formacioni më i mirë në të gjithë Divizionin. Ai ishte shquar sidomos kundër bandave në rajonet malore. Ai u shkëput prej Divizionit Hanxhar për të qenë në dispozicion.<sup>3</sup>

Në maj të vitit 1944, Divizioni e shtriu të drejtën për rekrutim edhe në prefekturën e Tetovës.<sup>4</sup> Rekrutimi i këtij divizioni u kthye në një çështje, sepse duhej përcaktuar roli i Qeverisë së Tiranës në këtë pjesë të marrëveshjes. Gjermanët (Nojbaheri) këshillonin që Tirana të mos ishte e përfshirë në këtë rekrutim dhe ky të bëhej në mënyrë vullnetare. Gjermanët duke njohur neutralitetin e Shqipërisë në konfliktin botëror kishin interes që Qeveria Tiranës të mos kishte probleme që mund të vinin nga njohja e këtij divizioni. Tjetër gjë që shqetësonte gjermanët ishte dhe një konflikt i mundshëm midis Xhaferr Devës dhe Mehdi Frashërit. Deva duhej të ketë qenë një nga këmbëngulësit për krijimin e këtij divizioni, gjë që shkonte kundër me qëndrimin e Mehdi Frashërit për të mbajtur neutralitet në këtë konflikt.<sup>5</sup>

Qëndrimi i Shtetit Shqiptar në lidhje me Divizionin shqiptar, qartësohet gjatë rekrutimit të tij. Çdo veprim për rekrutim është bërë nga zyrat ushtarake të Shtetit Shqiptar. Gjithësesi nëse qeveria e Tiranës miratoi vendimet e Komitetit Qendror të Lidhjes II-të Prizrenit. Vendime që lejonin krijimin në tokë shqiptare të një Divizioni malor SS, apo që liroi nga mobilizimi disa ditëlindje që të ishin të gatshme për mobilizim, mbajti një qëndrim kategorik, kur persona të ndryshëm, civilë apo ushtarakë braktisën pozicionet e tyre për tu veshur SS. Ushtarakë të Bateria Mati, Regjimenti 2, braktisën njësinë e tyre për tu veshur SS. Kjo u konsiderua si dezertim nga rradhët e ushtrisë shqiptare, prandaj u kërkua prej komandës së Divizionit kthimi i këtyre ushtarëve për tu gjykuar nga gjyqi ushtarak, ashtu siç ishte bërë dhe me ushtarë të tjerë para tyre.<sup>6</sup> E njëjta gjë ndodhi dhe me ata civilë që braktisën pozicionet e tyre. Mësuesi i shkollës së katundit Deçan, braktisi punën për tu veshur SS. Kryeministrisë iu desh të bënte me dije institucionet vartëse se nuk e njeh Divizionin SS Skanderbeg.<sup>7</sup>

Vendimi për bashkëpunim në krijimin e një Divizioni SS shqiptar u mor në një mbledhje të jashtëzakonshme të Komitetit Qendror të Lidhjes së II-të të Prizrenit mbajtur më 30 mars 1944. Mbledhja kryesohej prej kryetarit Bedri Pejani, merrnin pjesë dhe anëtarët e Komitetit, Musa Shehu, Nexhip Basha, Xhemal Kabashi, Sheh Hasani, Nuri Llahusha, Ndue Shahini, Abdyl Aga Shahini. Në mbledhje ishin ftuar gjithashtu Prefekti i Prizrenit Shaqir Curri dhe nën komandanti i Sektorit "Kosova" Ndreka Pepa.<sup>8</sup> Pasi u ra dakort me krijimin e tij, çështja kryesore që u diskutua ishte mënyra e rekrutimit. Divizioni të krijohet ashtu si çdo formacion usharak shqiptar, përmes zyrave të rekrutimit apo ashtu si dhe propozonte Ministria e P. Brendshme, përmes rekrutimit vullnetar. Të gjithë të



pranishmit ranë dakort me rekrutimin përmes zyrove të rekrutimit ashtu si të gjitha formacionet e ushtrisë Kombëtare.<sup>9</sup> Zgjedhja e një rekrutimi përmes zyrove shtetërore argumentohej me pranimin e gjithë popullsisë së Kosovës që meshkujt prej 15-60 vjeç të mobilizoheshin prej autoriteteve prandaj dhe mundësia e rekrutimit ishte e madhe. Situata e brendshme dhe ajo e jashtme - përfunduan pjesëmarrësit në mbledhje - kërkonte një organizim ushtarak serioz dhe radikal. Një rekrutim vullnetar mund të dështojë lehtësisht, sepse mund të formohej me njerëz "të hunit dhe konopit", ndërsa një rekrutim i organizuar nga zyrat shtetërore dhe mbështetur në ligj mund të japi një Divizion "nga më të mirët", ku do "të përmbledhet ajka e elementit serioz të Kosovës" si fizikisht ashtu dhe moralisht. Sistemi i vjetër i rekrutimit vullnetar duhej të merrte fund për tja lënë vendin një rekrutimi modern e nacionalist.<sup>10</sup> Në lidhje me rekrutimin e këtij Divizioni, vetë Komandanti i tij, kolonel August Shmithuber shpejgonte rëndësinë e të paturit në përbërje të tij elementë të shëndoshë ku pjesa më e madhe do të ishte nga vegjëlja. Prej vegjëlisë do buronte forca e këtij Divizioni, prej këtij do të dilnin oficerët dhe nënoficerët e rinj SS.<sup>11</sup> Rekrutimi vullnetar, por përmes zyrove ushtarake shtetërore nënkuptonte nxjerrjen nën lirim të disa ditëlindjeve dhe këtyre djemve tu krijohej mundësia për tu rregjistruar në Divizionin SS, por gjithmonë sipas vullnetit të tyre.<sup>12</sup> Vendimet e marra do t'i paraqiteshin për aprovim Qeverisë në Tiranë gjithashtu Komiteti Qendror i Lidhjes II-të Prizrenit do përpiqej pranë Qeverisë apo "kudo tjetër", që Divizioni SS Skanderbeg të mos shkojë në luftime jashtë kufinjve shqiptarë. Komanda e Sektorit "Kosova" do kujdesej që krijimi i këtij Divizioni të mos dëmtonte rekrutimin për formacionet e Ushtrisë Kombëtare.<sup>13</sup> Kryeministria në Tiranë çështjen e krijimit

të këtij divizioni e përcolli pranë Këshillit të Naltë për mendim.<sup>14</sup> rekrutimi Kushtet kryesorë për të qenë pjesë e Divizionit SS ishin, qenia i racës dhe gjuhës shqiptare.<sup>15</sup> Rekrutimi për në Divizion, kishte nisur edhe më parë se të bëhej mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit Qendror të Lidhjes II-të Prizrenit. Ky Komitet i kërkonte Drejtorisë Rekrutimit VI-të Prizren, numrin e atyre nënshtetasve të mobilizuar nga mosha 20-30 vjeç, për prefekturat Prizren, Pejë e Prishtinë. Komiteti i kërkonte këto lista me "urgjencë" sepse parashikonte që më 15 prill 1944 të niste organizimi. Vetëm për prefekturën e Prizrenit parashikoheshin që të mobilizoheshin 1500 veta.<sup>16</sup> Me urdhër të Komandantit të Mbrojtjes Kombëtare, gjeneral Prenk Previzit i kërkohet Drejtorisë së Rekrutimit VI dhe Komandës së Sektorit Kosova që ti vënë në dispozicion listat me "djelmoshat" e datlindjeve të kërkuara, për datlindjet që mungojnë gjenerali propozonte që Lidhja II-të Prizrenit të drejtohej direkt nëpër komuna.<sup>17</sup> Shumë shpejt, Zyra Rregullim e Mobilizim përmes Kryetarit të saj kolonel Hamid Tirana, bën një paraqitje të gjendjes së nënshtetasve shqiptarë të mobilizuar për tre prefekturat e sipërfolura duke bërë dhe propozimet përkatëse.<sup>18</sup> Ndërsa komandanti i Sektorit Kosova kërkonte nga zyrat vartëse të rekrutimit që të zbatoheshin rregullat në mënyrë kategorike. Nëse do të dalloheshin abuzime, oficerët dhe përgjegjësit "do ti jepeshin Gjyqit si sabotues në dam të brojtjes Kombare".<sup>19</sup> Vënia në dispozicion prej Komandës së Mbrojtjes Kombëtare të mobilizuarve në forcat e saj, për Divizionin SS, u bë me një marrëveshje midis palëve më 14 prill 1944. Marrëveshje që konfirmohet dhe nga vetë SS Brigadeführer e Generalmajor i Armëve SS e Pol. Fitzthum. Zyra përgjegjëse për

rekrutimin e SS shqiptar ndodhej në Prizren.<sup>20</sup> Komandant i Divizionit u caktua kolonel August Shmithuber.<sup>21</sup>

Pjesë e këtij Divizioni, shfaqën dëshirë të bëhen dhe një pjesë e mirë e robërve që erdhën nga Gjermania. Këta robër shqiptarë u liruan me ndërmjetësimin e Shteti Shqiptar. Me të mbritur në Tiranë një pjesë e tyre u tregua e gatshme për t'u veshur SS.<sup>22</sup> Me rastin e kthimit të këtyre robërve, vetë Komandanti i Divizionit August Shmithuber mbajti para tyre një fjalim përshëndetës.<sup>23</sup>

shenjta dalluese

Në takimin e 3 marsit midis zv. Ministrit të punëve të jashtme të Shqipërisë, Vehbi Frashëri me sekretarin Shtetëror të Rajhut të III, u diskutua edhe mbi simbolet që do të kishte Divizioni SS malor. Gjermanët duke menduar se shqiptarët, në shumicë myslymane, do pranonin ashtu si bosnjakët, simbole me përmbajtje fetare. Kjo gjë u kundërshtua me forcë nga zv. ministri Frashëri, i cili argumentoi se një përdorim simbolesh fetare do ngjallte pakënaqësi të madhe tek shqiptarët. Të pushtuar prej 500 vjetësh nga turqit, një përdorim simbolesh apo ngjyrash do t'u kujtonte shqiptarëve këtë pushtim. Shteti shqiptar, vazhdonte Vehbi Frashëri, ishte një shtet i ndërtuar mbi baza kombëtare dhe jo fetare.<sup>24</sup>

Një muaj më vonë, çështja e shenjave dalluese për Divizionin SS Malor ishte rregulluar. Ushtari SS shqiptar do të mbante në jakën e tij të djathtë përkrenaren dhe shpatën e Heroit Kombëtar, Skënderbeut. Në anën e majtë shenjta dalluese për çdo trupë SS dhe në mëngën e djathtë mburojën me stemën kombëtare shqiptare, si dhe mbishkrimin Skënderbeu.<sup>25</sup>

Në numrat e ardhshëm, veprimtaria e divizionit dhe operacioni Kokërisuri

1. Dokumente të institucioneve gjermane për historinë e Shqipërisë 1941-1944, përgatitur nga Dr. Hakif Bajrami, Vatra, Prishtinë 1998, fl. 195-197

2. Po aty, fq. 196

3. Po aty, fq. 222

4. Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë, Fondi. 158, Viti. 1944, Dosja 32, fleta. 42

5. Bajrami, Vep. Përm. fl. 198

6. A.Q. Sh. i R. Sh. F. 158, V. 1944, D. 32, fl. 18,20

7. A. Q. Sh. i R. Sh. F. 195, V. 1944, D. 34, fl. 21-23.

8. A. Q. Sh. i R. Sh. F.147, V. 1944, D. 165, fl. 15

9. Po aty.

10. Po aty, fq. 14, 16

11. Lidhja II Prizrenit Nr. 8, dt. 4.7.1944, Organi Komitetit Qendror të

Lidhjes II Prizrenit, E vërteta!, prej Komandantit të Divizionit Malsuer SS

"Skanderbeg", fq. 1

12. A.Q.Sh. i R. Sh. F. 158, V. 1944, D. 32, fl. 9

13. Po aty, fl. 16

14. A. Q. Sh. i R. Sh. F. 147, V. 1944, D. 165, fl. 13. Dokumenti ka

shënimin me dorë "Të pyetet Këshilli Ministrues se si mendon mbi

çështjen që bëhet fjalë më sipër, në mbledhjen që ka me bën pranë këtij

Këshilli".

15. A.Q.Sh i R. Sh. F. 158, V. 1944, D. 32, fl. 13

16. Po aty, fl. 1

17. Po aty, fl. 2

18. Po aty, fl. 3

19. Po aty, fl. 10

20. Po aty, fl. 4

21. Lidhja II Prizrenit Nr. 8, dt. 7.5.1944, Organi Komitetit Qendror të

Lidhjes II Prizrenit, Kthimi i ushtarëve kosovarë t'ish ushtrisë jugosllave

qi ndodheshin në Gjermani si rob. fq. 4.

22. Bajrami, Vep. Përm. fq. 234

23. Lidhja II Prizrenit Nr. 8, dt. 7.5.1944, Organi Komitetit Qendror të

Lidhjes II Prizrenit, Kthimi i ushtarëve kosovarë t'ish ushtrisë jugosllave

qi ndodheshin në Gjermani si rob. fq. 4.

24. Bajrami, Vep. Përm. fq. 195-195

25. Po aty, fq. 221

August Pinoçet

REZISTO PUSHTIMIT  
REFUZO REFUGJATË  
NË SHQIPËRI

Roli i të majtës në fenomenet emigruese

Sigurisht që hetimi i arsyeve të politikave mbi emigracionin, që ndjek e majta në Perëndim, shfaqet i vështirë, ose më mirë shfaqet i vështirë sa kohë përpiqesh të qëndrosh në rrafshin e të natyrshmes. Kur themi "të natyrshmes", kemi parasysh dhe gjërat më të nënkuptuara, të nënkuptuara pikërisht për shkak të vlerës së tyre të pandryshueshme dhe instiktive, siç mund të jetë edhe dera me të cilën gjithmonë është dhe do të vazhdojë të jetë i pajisur çdo apartament. Derë që në vetvete, si do të vinte në dukje Magli, shënon një kufi, një kufi ndarës dhe mbrojtës i cili nuk mund të kalohet pa lejen e të zotit të shtëpisë.

Por, nëse rrëshqasim nga e natyrshmja te abstraktja, te përpunimi mbi përpunimet pseudointelektuale çështja fillon të marrë formë. Të majtët kanë nevojë për refugjatët, kanë nevojë për të vazhduar të jenë të majtë. Një nga shtyllat e mendimit të majtë ka rënë, madje filloi të binte që kur i ati ishte gjallë; punëtorët nuk janë më të pistët e Zolas (dhe për të qenë të saktë nuk ishin as ato fytyrat e qeshura dhe krenare të njëqind lekëshit shqiptar). Në një proces psikologjik, të ngjashëm me atë të përshkruar nga Malaparte kur të rinj të fillimit të viteve '40 për t'u ndjerë (më) komunistë i jepeshin homoseksualizmit, të majtët kanë nevojë për punëtorë të varfër për t'u ndjerë më të majtë. Aq e vërtetë është sa mund të vihet re pa sforcim artificialiteti me të cilin, në Shqipëri dhe në pjesë të tjera të Evropës, fraksione të majta përpiqen t'i bashkëngjiten betejave të veçanta të ndonjë kategorie të caktuar punëtorësh. "Artificialitet" që shkakton një zhvendosje të vëmendjes nga objekti fillestar, denatyrizon dhe në fund të fundit dëmton dhe subjektin e interesuar në vetën e parë.

Ky është një proces psikologjik, por ka dhe një anë tjetër, shumë më të prekshme; të majtët kanë nevojë për vota.

Një ndërthurje faktorësh kanë sjellë që e majta radikale – për të përdorur një shprehje të rëndomtë – dhe ajo me prejardhje radikale të humbasin pjesë të rëndësishme, nga pikëpamja e numrave, të elektoratit të tyre. Të atij elektorati të vendosur, militant dhe jo rrallëherë depozitë e metodave të tyre të jashtëligjshme (ose klasike, sipas pikëpamjeve).

Kjo rënie e pandalshme e elektoratit duhej ndalur dhe refugjatët dukeshin e vetmja kategori në gjendje të plotësonte modelin tipik (padyshim dhe kutitë e votimit). Në pamje të parë mbështetja ndaj emigracionit masiv, do të mund të shfaqej si "tradhti ndaj proletariatit ekzistues", pasi më shumë krahë pune do të thotë dhe ulje të pagës dhe rrjedhimisht humbje të vendeve të punës. Por, në shkallë përfundimtare, kjo spirale varfërimi e shtresave të mesme dhe të ulëta vendase, sipas modelit historik, do të shkonte në përfitim të së majtës.

Në këtë pikë nuk mund të mos merret në konsideratë edhe një element i tretë, doktrine dhe themelor për ideologjinë komuniste. Marksizmi ka në bazë shkatërrimin e strukturave sociale dhe identitetit ekzistues, identitet që përbën dhe arsyen e ekzistencës së strukturave, dhe rikrijimin e tyre, në një proces të vazhdueshëm që Bukovskij do e quante të inxhinierisë njerëzore. Pas sulmit ndaj strukturave, si familja dhe kombi dhe formave klasike të mendimit, i është drejtuar bazës së identitetit, përkatësisë etnike dhe racore, duke u kthyer në flamurtaren e martesave të përziera dhe në përgjithësi të raporteve të përziera (qoftë dhe atyre të pavullnetshme), që gjithmonë e më shumë paraqiten si shkalla më e lartë e emancipimit. Zhvendosim vëmendjen në Shqipëri: përpjekja për të analizuar gjendjen has kundërshtimin, e cekët, se kushtet tona politike dhe ekonomike janë të ndryshme nga ato të Perëndimit. Pjesërisht e

vërtetë. Themi pjesërisht pasi në qëndrimet e të majtës shtohet një element, që është kthyer në dominuesin e politikës shqiptare; legjitimimi i jashtëm. Çdo parti në përpjeke për të justifikuar marrjen apo mbajtjen e drejtimit të qeverisë, ka përdorur si një nga elementët kyç të formimit të mjedisit të përshtatshëm mbështetjen e “partnerëve tanë strategjikë”. Mbështetje që arrihet, mes të tjerave, dhe duke ndjekur me zell vija të përgjithshme politike. Kjo u pa qartë në fillimet e të ashtuquajturës krizë të refugjatëve, kur Gjermania po luante me politikën e dyerve të hapura. Qeveria e majtë shqiptare u nxitua të vinte në jetë një fushatë propaganduese në shtyp dhe një varg masash të prekshme për pritjen e “refugjatëve”. E gjitha përfundoi me ngjyrimë tragjikomike, ku “e dërguara jonë në Korçë”, pasi kaloi ditë duke përshkruar nevojën e mikpritjes dhe masat e marra nga qeveria, përfundoi me tone vetëfshikëlluese pse “refugjatët” nuk po ja varnin Shqipërisë. E gjora kaloi ditë të tëra në kodrinë duke parë me dëshpërim mënjanimin e kufirit shqiptar nga e ashtuquajtura rrugë Ballkanike. Kjo ishte ana komike, ana tragjike qëndron në faktin që mjetet, ambientet dhe energjitë që qeveria parashikonte të vinte në dispozicion të “refugjatët” as nuk u shkuan ndërmend të përdorëshin për të përballuar ditët e ftohta të dimrit 2017. Të gatshmit për të përshtatur repartet ushtarake për të huajt, kaluan dimrin duke numëruar shqiptarët e vdekur nga të ftohtët.

Në këtë pikë duhet vënë në dukje që nëse në brezin më të vjetër të së majtës mbizotëron mentaliteti servil dhe reminishenca internacionaliste, më të rinjtë shfaqin një zhvillim ideologjik tipik të marksizmit kulturor, çka në të ardhmen do të sjellë qëndrime që shkojnë përtej nevojës së “legjitimitit”. Sa i përket anës ekonomike, paçka krizës, falë politikave qeveritare, në vitet e fundit numri i punëtorëve të huaj vetëm është rritur.

Nuk flasim për të specializuarit, por për krahun e thjeshtë të punës, atë që po zëvendëson punëtorin e pa specializuar shqiptar, duke filluar nga kinezët e minierave, turqit e ndërtimeve dhe deri te qindra kolumbianët e TAP-it. Pra, disa mijëra të huaj që provojnë se niveli i ulët ekonomik nuk shërben si barrikadë ndaj vërshimeve të huaja. Vërshime që do të jenë gjithmonë e më të rëndësishme duke parë shpërthimet demografike që janë të afta të kryejnë vende të caktuara. Në atë situatë, Shqipëria jo vetëm që do të përfaqësonte një vend me paga të kënaqshme për miliona e miliona njerëz por, në fund të fundit, dhe një hapësirë jetësore, për ata. Në këtë drejtim nuk mund të mos bëjnë përshtypje propozimet për një të ashtuquajtur “shtetësi të përkohshme shqiptare” apo për kthimin e vendit në njëfarë porti të lirë, në kuadër të “korridoreve humanitare”.

Si përfundim mund të themi se niveli ekonomik, hapësira gjeografike dhe mbi të gjitha politikat dhe nevojat e të majtës krijojnë parakushtet e mundësisë që Shqipëria të rrezikojë të përballet me fenomene të ngjashme dhe të krahasueshme me ato në Perëndim, ku nata e Vitit të Ri në Këln përfaqëson shembullin më tipik, por për fat të keq, jo më të dhimbshmin.

Bardhyl

---



---



---

## Teatri partizan eksperimental

Shfaqja e fundit vënë në skenë në Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" është një nga ato raste kur duhet të shtrohet pyetja se çfarë eksperimentohet në teatrin eksperimental. "Çfarë pa kryeshërbëtorja" është një shfaqje mbi atë që rëndom quhet identiteti seksual, çka në të vërtetë përshkruan, si gjithmonë, përpjekjen e një pakice për t'ju imponuar natyrës. Gjatë paraqitjes së veprës, Teatri "ynë" nuk harroi ta cilësonte autorin, Joe Orton, si një nga dramaturgët më të mëdhenj të pasluftës. Kuptojmë modën e dhurimit të epiteteve, por nuk duhet të harrojmë që në skenat e rëndësishme nuk e hasim shpesh. Interesant është shkrimi i J. M. Charlton, botuar në The Guardian në vitin 2009, mbi nevojën që supozohet të ketë teatri britanik për rivlerësimin e veprës së Ortonit. Pothuajse të gjithë argumentet janë jashtë artistikë dhe lidhen me jetën dhe sjelljet e autorit, çka duket e drejtë për sa kohë jeta e autorit është kthyer në çelësin e suksesit të veprës së tij. Charlton e nis artikullin duke nënvizuar që Ortoni dhe dashnori i tij Kenneth Halliwell patën një jetë të guximshme dhe radikale(!). Ortoni pati një jetë vërtetë interesante, në disa pikëpamje. Ekonomikisht mbahej nga partneri i kamur, deri në ditën kur ky i fundit, për çështje xhelozie, vendosi t'i jepte fund, me çekiç kokës, lidhjes së tyre. Edhe funerali ishte interesant, në kërkim të romancës dhe mitit për ambiente të caktuara, vendosën që trupat e Ortonit dhe Halliwell-it, i cili u vetëvra pas krimit, të digjeshin dhe hiri i tyre të përzihej. Gjatë funeralit mori fjalën një tjetër personazh interesat, Harold Pinter. Një përfaqësues i dalluar i teatrit të absurdit dhe në vitin 2005 i nderuar me çmimin Nobel për letërsinë. Pinteri në fundin e viteve '40 nuk pranoi të kryente shërbimin ushtarak, duke e deklaruar aktin si një formë proteste ndaj Luftës së Ftohtë,

por duke theksuar që padyshim do të kishte qenë i gatshëm, nëse mosha do ta kishte lejuar, të vishej ushtar kundër Gjermanisë naziste. Njeriu që donte të luftonte nazistët nuk donte të vishte uniformën kundër komunistëve. Kjo sjellje politike do të ishte e pandryshueshme gjatë gjithë jetës së tij. E gjejmë të rreshtuar kundër embargos ndaj Kubës, e gjejmë kundër bombardimeve të NATO-s në ish Jugosllavi, e gjejmë duke etiketuar Xhorxh W. Bushin si nazist dhe, qershia mbi tortë, e gjejmë të rreshtuar përkrah Slllobodan Milosheviçit. Në vitin 2001 Pinteri përfshihet në një Komitet Ndërshtetëror për Mbrojtjen e Slllobodan Milosheviçit (ICDSM). Ky Komitet, ku Pinteri përfaqësonte një nga njerëzit më në dukje, kërkonte një gjykim të ndershëm dhe lirimin e Slllobodanit. Sipas tyre procesi gjyqësor ndaj Milosheviçit paraqiste një situatë orwelliane (!), se dëshmitarët ishin të rremë dhe se të akuzuarit për krime ndaj njerëzimit duhet të ishin, jo Slllobodani, por Gjenerali Klark dhe vetë NATO. Në këtë pikë, çdo kush mund të pyesë pse po flasim kaq gjatë për këtë Pinterin; në të vërtetë po vazhdojmë të flasim për Teatrin Kombëtar Eksperimental "Spahivogli". Në tetor të vitit 2016 në atë skenë u vu shfaqja "Kthim në shtëpi" e Pinterit, që me atë rast u përshkrua thjesht si nobelisti britanik. Pra, një institucion shtetëror, si Teatri Kombëtar, vë në skenë vepra të një mbështetësi të flaktë të Milosheviçit, thënë ndryshe taksapaguesi shqiptar detyrohet të marrë pjesë në pasurimin e trashëgimtarëve të njeriut që mohonte masakrimin e mijëra shqiptarëve, detyrohet të shpërblejë një njeri që shkel mbi kujtimin e viktimave të pafajshme, mbi dëbimin e qindra mijëra shqiptarëve dhe përdhunimin e shqiptarëve (nuk mund të mos tingëllojë si poshtërim me efekt të vonuar përshkrimi nga ana e



Teatrit se vepra e Pinterit është një përpjekje për të tejkaluar dhunën e burrave ndaj grave) Viti 2016 ishte interesant për Teatrin Kombëtar Eksperimental "Spahivogli"; një nga shfaqet më të rëndësishme të vënë në skenë ishte "Made in Albania", një shembull tipik i "artit" në shërbim të politikës, një apologji ndaj masave fiskale dhe agresivitetit të treguar nga qeveria ndaj sektorëve të caktuar të ekonomisë, për të qenë më të saktë atij privat. Për ta pozicionuar veprën, kujtojmë disa shifra: në vitin 2014 sektori i ashtuquajtur fason, në Shqipëri, u rrit me 25% krahasuar me vitin paraardhës. Një vit më vonë, falë politikave të austeritetit të qeverisë (kupto rritjen e kostos së biznesit), ky sektor u rrit me vetëm 3% dhe ishte sektori që përbënte 35% të eksporteve shqiptare.

Në këtë klimë vjen në skenë "Made in Albania", që cilëson fabrikat shqiptare, as më shumë e as më pak, si kampe përqendrimi, naziste kuptohet, e sipërmarrësit privatë shqiptarë si një tufë kriminelësh përdhunues që pashmangshmërisht do të përfundojnë duke vrrarë njeri tjetrin.

Në një analizë të përgjithshme të Teatrit mund të themi se në vitin 2016 mori trajtën e një teatri politik, teatër agjitpropri sipas një përkufizimi ose, për të ndjekur traditën, teatër partizan.

Por pyetja, në krye të herës ishte se ç'eksperimentohej në teatrin eksperimental? Asgjë, asgjë e ndryshme nga ç'eksperimentohet në çdo organ të politizuar nga e majta; tjetërsimi i identitetit të njeriut dhe të shqiptarit... dhe kjo bëhet me lekët e tua.

Ujk

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Popullariteti si problem

Marksizmi është teori dhe përpunim mendor më i ndërlikuar nga sa studiohet sot, (vetëm sipas tipit të tipit realizmi-socialist, çka rezultoi se është studiuar vetëm procesi i kërkimit të armikut të brendshëm të proletarietit). Në të vërtetë: Marksi ka dalë nga gjiri i idealizmit gjerman në fillim shek. XIX; i ndikuar thellë nga idetë e Hegelit, gjithashtu edhe Fjorbahut, që në të njëjtën kohë është përfaqësuesi kryesor i hegelizmit të majtë, në momentin që e quante veten materialist ishte i mbushur plot e përplot me filozofinë idealiste dhe për më tepër mbeti njëfarë teologu. Doktrina marksiste është armë revolucionare, dhe kryesisht armë kundër rrymave të vjetra, që çuditërisht cilido krah të ketë pushtetin përlllogarit si i tillë. Në këtë këndvështrim jep baza të forta për tu interpretuar si një sistem konsekuent të determinizmit sociologjik.

Determinizmi ekonomik i Marksit ka në karakter krejt të veçantë, është demaskimi i iluzioneve të ndërjegjes. Marksizmi nuk është vetëm doktrina e materializmit historik dhe ekonomik, që pohon varësinë e plotë të njeriut nga ekonomia, "marksizmi është gjithashtu doktrina e shpëtimit, e thirrjes mesianike të proletarietit, e shoqërisë së ardhme të përsosur, e fuqisë dhe fitores së njeriut mbi forcat irracionale të natyrës së shoqërisë. Njeriu është përcaktuar tërësisht nga ekonomia në shoqërinë borgjeze, por kjo i takon së kaluarës. Përcaktimi i fatit të njeriut, i qenies së tij nga ekonomia, mund të interpretohet si mëkat i së kaluarës. Por në të ardhmen mund të jetë ndryshe, njeriu mund të çlirohet nga skllavëria, rrjedhimisht subjekti veprues i cili do ta çlirojë njeriun nga robëria dhe të krijojë një jetë më të mirë, është proletariati. Por, në të vërtetë, njeriu në rrugën e zhvillimit të tij, ishte dhe vazhdon të jetë kafshë shoqërore,

ashtu si shumë kafshë si ujçit, shpendët, bletët, etj.

Intelekti i tij thjesht i ka dhënë dhe përmasë virtuale këtij realiteti, për ta fuqizuar më tej, por nuk është vetë intelekti i tij krijues i këtij realiteti dhe nuk ishte njeriu që e zgjodhi këtë realitet. Kështu, në këtë përmasë virtuale lind dhe problemi i kontratës shoqërore dhe i dogmave egalitariste që ndërlidhen me të si demokracia, komunizmi, fetë, (që edhe pse të artikuluar në mënyrë të ndryshme, ajo çka në thelb kërkohet prej tyre është e njëjta gjë, shkatërrimi i dasive raciale, dhe shembja e hierarkisë organizative kombëtare e bërë në emër të konsumerizmit dhe globalizmit sot). Pra ide të caktuara të disa njerëzve që shtrembërojnë organizimin natyror të shoqërisë me vlerat e tyre në thelb hedoniste, kryekëput subjektive dhe pa asnjë relevancë me realitetin.

Organizimi shoqëror biologjik, si më i qëndrueshmi, është instinktiv, nis nga familja dhe mbaron në shkallën e farës, aty ku mbaron dhe vija e gjatë evolutive e paraardhësve të përbashkët biologjikë. Farat po ashtu janë të pavarura nga njëra tjetra dhe me veti të plota të llojit, pra, mund të kryejnë përjetësim të llojit pa pasur nevojë për farat e tjera. Çdo organizim tjetër është artificial dhe duke qenë se nuk vjel prej bazës biologjike (e cila ekziston pavarësisht inteligjencës), është inferior.

Komunizmi, demokracia, besimet monoteiste të ardhura nga lindja e mesme, të gjitha në bazë kanë popullaritetin, në to gjithmonë fiton më popullori, rrjedhimisht jo më i afti çka në normalitet do të rriste funksionalitetin natyror të shoqërisë.

Këto sisteme kinkulariste kërkojnë prej grupimeve të ndryshme biologjiko-kulturore të sillen, veprojnë, mendojnë njësoj, duke iu detyruar të gjithëve një mënyrë të vetme jetese, mendimi, veprimi, shprehjeje, që nuk përputhet gati me asnjërin dhe shkel liri themelore e të

nevojshme për mbarëvajtjen normale të zhvillimit shoqëror të këtyre grupimeve, dhe nëse grupimet homogjene subjekte të regjimit vazhdojnë t'i bëjnë ballë kësaj mënyre (siç ndodh gjithnjë përdërisa shtysat biologjike janë më të forta se dogmat politike, dhe siç shihet në SHBA dhe sot ku reaksioni biologjik bën që zezakët të vazhdojnë të jenë zezakë, dhe të bardhët të bardhë, por, çuditërisht zezaku psikologjik i veshur me rrobat e liberalizmit po tregohet shumë aktiv për të krijuar mentalitetin e të riut pa punë dhe profesionist protestash) dhe të mos asimilohen në njëtrajtësimin racor të propaganduar kaq shumë, tensioni i brendshëm i krijuar duke pamundësuar marrjen e vendimeve funksionale për tërësinë e organizimit sjell në fund rënien e regjimit, sepse çdo vendim shkel mbi përjetësimin e grupimeve biologjike që e përbëjnë atë, sa që kohezioni heterogjen rezulton i paarritshëm në sisteme të centralizuara dhe në çdo rast mbetet sipërfaqësor e i përkohshëm deri në degradim ose shpërbërje të sistemit.

Tërë ideja për këtë organizim gjithëpërfshirës jonatyror sipas species dhe krijim njëtrajtësie në shkallë bote, me ose pa vetëdije (sepse duke promovuar përzierjen e farave në emër të "diversitetit", dhe duke krijuar diversitetin abuzivisht brenda grupimeve homogjene faktikisht janë duke shkatërruar "diversitetin"), është ndërhyrje artificiale dhe dogmë trans-seksualiteti, egalitariste, që mbin mes demokracie, komunizmi, feje, injorance e mediokriteti të çdo forme dhe përmasë, pra një mut dinozauri që kujton se bota dhe ligjet natyrore sillen rreth zhvillimit të "arsyes dhe zhvillimit të inteligjencës brenda realitetit që pa ardhur si pasojë e komplikimeve gjatë procesit të ndërrimit në konstrukt mendor pa e prekur fare realitetin.

Fanatikët e këtyre dogmave të rrafshimit biologjik e kulturor janë përpjekur të shtrembërojnë dhe "shkencën" për të akomoduar doktrinat e tyre socio-

psikologjike, sidomos këto 60 vjetët e fundit, duke imponuar me prepotencë idiote shprehje pa kuptim si "raca njerëzore". Ndoshta duhet të dalin nga betoni dhe të studiojnë dhe njëherë realitetin dhe jo të projektojnë hedonizmin e tyre mbi të.

Fakti që marksizmi për nga pozicioni ku është shikon realitetin si kazan i mbushur me realitete plot ngjyra, së pari nuk tregon ndonjë zhvillim të madh intelektual (nga çka pretendohet sot), por, dhe as nuk ka substratin e nevojshëm për tu marr seriozisht si tezë (këtu kam gjithmonë për bazë mendjet e pa infektuara).

Nuk është e çuditshme pra që këto dogma burojnë nga impulse të doktrinave fetare apo janë krejt të ngjashme me to, dhe janë mbarëbotërore, pra kërkojnë të imponohen dhe të zbatohen dhunshëm në shkallë bote dhe nuk marrin parasysh realitetin natyror me veçoritë e tij dhe lokalitetet biologjike të Tokës, e pak a shumë iu duket vetja si "ndërtues të realitetit".

Si demokracia, si konsumerizmi, si komunizmi, si fetë abrahamike kanë për qëllim njëtrajtësimin e tërë racës dhe krijimin e "njeriut të ri" mbarëbotëror e në këtë mënyrë turma e mediokërve arrin më në fund mediokritet institucional ku asnjë nuk mund më ta sfidojë pushtetin e turmës. (çka sjell që njerëzit gjithmonë të thonë "ky vend s'bëhet", edhe pse nuk kanë punuar asnjë ditë në jetë). Ky lloj magazinimi biologjik është më i lehtë të kontrollohet nga grupet që kanë fuqi ekonomike në dorë (pra qeverisje tregtare dhe jo shoqërore) dhe duke qenë se magazina e errësuar ka shkëputur çdo lidhje me realitetin mund të manipulohet në çfarëdolloj forme në mënyrë masive që është dhe arsyeja pse feja, egalitarizmi, konsumerizmi dhe "tregu i lirë" promovojnë fuqishëm njëtrajtësimin e planetit. Pra, a nuk janë këta që promovojnë mungesën e higjienës personale dhe pëllasin lart e poshtë për zhdukjen e gjithë dallimeve ndërkohë që sa herë flasin keqinterpretojnë dhe vetë

termin "diversitet"?! dhe teksa dallimi është gjëja më natyrore e mundshme, si p.sh. unë jam mashkull dhe dua të mbetem i tillë, përkthehet si çmenduri e krijuar nga kasta e vjetër, dhe gjithashtu kërkohet edhe uniformizim, rrafshim total i gjithçkaje që natyra ofron, i çdo veçorie (që quhet e tillë sepse është e veçantë), me synimin e vetëm absurd për të arritur homogjenitet artificial biologjiko-kulturor në shkallë bote, pra një planet pa dallimi raciale por i stërmbytur me dasi psikologjie dhe masturbime mendore. Si të marrësh p.sh. tërë llojet e farat e ujëve dhe të qenve dhe t'i kryqëzosh për të nxjerrë vetëm një lloj të ri substandard as qen as ujk dhe këtij të fundit ti shtosh edhe propagandimin deri te mënyra se si ushqehet, dhe të gjitha këto në emër të "diversitetit"!... Dhe në përfundim janë po këta të kalbur që hedhin akuza kundër kombëtarëve për gjoja uniformizim dhe diktaturë, pa ditur as kuptimet themelore të fjalëve që përdorin dhe as të dogmës absurde vdekjeprurëse që predikojnë!

Fronti Lindor

KUJTO GJITHMONË

MË MIRË I VDEKUR

SE I KUQ

M V S K

Ezra Pound  
Valuta puna dhe dekadencat

Një komb që nuk do të jetë borxhi  
shkakton zemërimin e fajdexhinjve.

Pjesa I

Perandoria e lashtë Romake ra pasi nuk mbrojti valutën punë, nuk mbrojti fuqinë blerëse të prodhuesit të grurit. Fuqia e Romës antike lindi me ligjet Iciniane\* e filloi të bjerë me «dumbing-un», pra me importimin me çmim të ulët të grurit egjiptian. Emërtim «romak» mbeti derisa i biri i një bariu bullgar u bë perandor. Sot emërtimi «demokraci» u ka mbetur fajdokracive, ose nëse dëshironi një fjalë të saktë nga pikëpamja akademike, por ndoshta më pak të kuptueshme: daneistokracive, që do të thotë mbizotërimi i atyre që japin hua. Lufta ndaj «das Leibkapital» u shpall nga Hitleri dy vite pas marshimit mbi Romë, por në Amerikë vazhduan të përdornin një terminologji që nuk përputhej më me faktet. Sistemi i Shteteve të Bashkuara, ideuar nga John Adams dhe kolegët e tij, ishte një sistem shtetëror.

Në tokën e egër nuk ishte, dhe ende nuk është, i mundur një organizim i zhvilluar në nivelin evropian. Ajo që ende nuk kuptojnë në Amerikë, ashtu edhe në Evropë, është që ky sistemi shtetëror amerikan u zhduk pas vrasjes së Lincoln-it. Nuk u zhduk si pasojë e një revolucioni të hapur dhe të ndershëm. Sistemi i tradhtua dhe ra. U shkri çdo gjë që ishte shtetërore apo me përfaqësim. Pushteti u dobësua, populli u mashtrua dhe Shtetet e Bashkuara mbetën një daneistokracio, një fajdokraci fal manovrave të Rothschild, Ikleheimer, Morton, Vandergould efajdexhinjve të tjerë dhe të tradhtarit J. Sherman, deputet i Ohajos. Si kam theksuar disa javë më parë duke cituar Overholser-in (History of Money in the USA), tradhtia u krye nëpërmjet hileve bankare, bonove si baza bankare,

etj. Është koha të lëmë mënjanë disa fetiçizma. Shën Luigji mbreti i Francës më 1897 pagoi për kurorën me gjemba një shifër që Brook Adams e përllogarit të barabartë me një milion dollarë. Shifra në monedhën e kohës është e njohur. Pas betejës së Tiberiadës\*\*, kryqtarët nuk kishin më besim te reliktet. Po lindte fuqia detare e Venecias. Në ditët tona Roosvelt-i pagoi miliarda dollarë për një substancë pothuajse të padobishme. Padyshim një substancë më e dobët se peçikllasi apo beriliumi.

Është koha të lëmë mënjanë besëtytnitë kafshërore, respektin e verbër për talismanin flori, fetishin patkua kali fatsjellës. Kasaphana e ushtarëve anglezë do të ishte haraçi i fundit paguar besëtytnisë kafshërore, respektit ndaj metalit të verdhë. Komb i lirë është kombi që nuk e vendos kontrollin e fuqisë së tij blerëse në duart e të tjerëve. Evropa nuk prodhon flori dhe as nuk ia ka nevojën. Kjo «Evropë» përfshin Italinë, Gjermaninë dhe makar Francën e Ishujt Britanikë. Nëse doni të çlirohemi nga Beit-i, nga çifutët pronarë të minierave të floririt në Afrikë, nga minierat sovjetike, duhet t'i hapni sytë. Floriri nuk hahet. Një komb ka nevojë për grurë, lesh, lëkurë, por jo për kinkalerira. Të debatosh qeveritë e të ashtuquajturave demokraci: Anglia, Franca, Shtetet e Bashkuara, është thjesht që humbje kohe, për sa nuk bëhet dallimi mes teorisë dhe faktit.

Këto tre vende janë të kontrolluara nga fajdexhinjtë, janë fajdokraci apo daneistokraci, dhe është plotësisht e kotë të flasësh sikur të ishin të kontrolluara dhe qeverisura nga popujt tyre ose të deleguarit, apo të ishin të qeverisura në interes të popujve të tyre. Duhet të pyesim deri në çfarë pike dhe në ç'përqindje të rasteve një deputet apo një tjetër i ngarkuar përgatitet tu zgjedhur duke u futur në borxhe. Deputeti borxhli do të jetë shërbëtor i bindur i kreditorit të tij, dhe nëse kreditori është një bankë apo një



trust ky kreditor bën një pjesë të madhe të punës që sjell i deleguari i sipërpërmendur, deputet apo sherif qoftë. Shtypi kushton shtrenjtë, po themi dhjetë milionë dollarë për të hapur një të përditshme. Shtyp i lirë? Aspak. Në vitin 1939 vetëm pesë nga të përditshmet më të njohura në Shtetet e Bashkuara administroheshin pa humbje ekonomike. Një drejtor thoshte: «Nuk mund të gjëj më një kredi afatgjatë. Më japin hua me afat jo më të gjatë se tre muaj». Pra kontroll i drejtpërdrejtë.

Humoristët e Boshtit më shoqërojnë në fushën e «parimeve» por nuk botojnë karikatura të drejtorëve të Bankës së Anglisë, patriotizmi i lartë dhe etja për të fituar luftën në emër të lirive demokratike i të cilëve shfaqet hapur në mbledhjen e drejtorisë. Veprimi i parë i mobilizimit ishte dyfishimi i pagës së vet. Kështu përfiton mirënjohjen dhe lavdinë. Ata janë kaq «human». Dhe kaq anglez: Goschen, Neimeyer, Strakosch, Kleinwort, Hambro fajdexhiu i mirë që ja mbathi nga Norvegjia duke marrë me vete të hollat dhe duke nxitur norvegjezët që në mungesë të tij të luftonin.

Metodat e fajdokracisë janë të atij lloji që Dantja i gjente në fund të Ferrit:

Si në rrethin e nëntë, qelbësirë.

800 000, pak a shumë, ushtarët me ngjyrë në Francë, për të zëvendësuar evropianët, janë të paguar për të mbështetur Lazard-ët, Rothschild-ët dhe veglat e tyre si Handel-i e të tjerë, pasi fajdexhinjtë mund të mashtrojnë më lehtë këta të mjeruar sesa fshatarët francezë. Dhe kështu do të jetë gjithmonë aty ku mbretërojnë fajdexhinjtë. Fajdexhiu do të shkatërrojë çdo rend social, çdo gjë të mirë, çdo gjë të bukur. Dallimi etik mes ndarjes së fryteve dhe taksës fikse është thelbësore. Kush ka hipotekën nuk e vret mendjen për ecurinë e fabrikës, fermës apo shtetit. Nëse falimentojnë, ai mbetet pronari.

Çdo komb që lejon një shtet fajdexhinjsh

në gjirin e shtetit zyrtar, rrëzohet, bie në dekadencë.

Kush nuk interesohet për proceset ekonomike dhe monetare është një i palexuar. Sa për kronikë, C. H. Douglas prej kohësh pohon se kjo luftë e nisur nga internacionalja fajdexhie është një luftë kundër anglezëve ashtu siç është kundër gjermanëve. Ai thotë që është një luftë në dobi të fajdexhinjve internacional, kundër të gjithë popullsisë së bardhë të Evropës. I drejtë apo jo ky vëzhgim i Douglas-it ne mund të marrim si aksiomë që fajdexhinjtë janë dhe do të vazhdojnë të jenë, deri sa të vërviten në rrethin më të ulët të ferrit, armiqtë e çdo populli me kulturë të lartë, kundër çdo ndjesie të gjallë të realitetit dhe veprimeve të një qytetërimi të lartësuar, kjo për faktin e thjeshtë që sa më shumë ju të kuptoni ligjet e mekanizmit social aq më e vështirë do të jetë të mashtroheni nga mashtrimi flori, apo nga mashtrimi bankar.

\*Leges Liciniae Sextiae – Ligje të miratuara në vitin 367 p. e. s. dhe sipas shumë studiuesve shënojnë mbylljen e fazës arkaike në historinë romake. Ligji parashikonte që një prej dy konsujve që drejtonin shtetin të ishte plebe, ndërsa tjetri patric. Gjithashtu parashikohej që fajdetë e paguara të përlllogaritëshin në ulje të kapitalit dhe që debitori të mund të shlyente kreditorin në tre këste të barabarta vjetore.

\*\*Njohur dhe si Beteja e Hattinit (1187), zhvilluar në kuadër të kryqëzatave. Pas fitores, ushtritë e Saladinit arrijnë të pushtojnë edhe kampin e kryqtarëve duke shtënë në dorë të ashtuquajturin "Kryqi i Vërtetë", që supozohej të ishte kryqi ku u kryqëzua Jezu Krishti. Që prej atëherë relikti u cilësua i humbur.


Vijon në numrin tjetër.

Botuar për herë të parë në «Rassegna Monetaria» 1937 dhe «Meridiano di Roma» 1943.

Përkthimi dhe shënimet Red. Nutrika.



NUTRIKA NË RESPEKT TË LIGJEVE NË FUQI TË REPUBLIKËS SHQIPTARE DHE TË TRADITAVE MË TË MIRA TË POPULLIT SHQIPTAR, NDIHET PËRGJEGJËSE VETËM PËR SHKRIMET PUBLIKUAR NË EMËR TË REDAKSISË. SHKRIMET E PALËVE TË DYTA PASQYROJNË MENDIMET E AUTORËVE PËRKATËS DHE JO DOMOSDOSHMERISHT TË REDAKSISË. PËRDORIMI I MATERIALEVE MBROJTUR NGA E DREJTA E AUTORIT KA VETËM QËLLIME DIDAKTIKE DHE JO EKONOMIKE. PËR SA MË LART, NUTRIKA NUK NDIHET PËRGJEGJËSE PËR THARTIME APO LËNDIME MENDJENDRITURISH.



# OSHTIMA

Shtypja e kësaj fletoreje është bërë me kontribut vullnetar. Nuk ka një çmim por ka një kosto. Shpërndahet falas.